



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI KONKURRENCËS

Nr. 666/prot.

Tiranë, më 11.09.2025

12

VENDIM

Nr. 1209, Datë 11.09.2025

“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË PËRLLOGARITJE TË GJOBËS SË VENDOSUR SHOQËRIVE BALFIN B.V. DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE ME VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1208, DATË 27.08.2025, “PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE BALFIN B.V., BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, JUST FUN BALKANS SHPK DHE JUST FUN DISTRIBUTION SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Për një korrigjim gabimi në përllogaritje të gjobës së vendosur shoqërive Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1208, datë 27.08.2025, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK”.

Baza Ligjore:

Neni 2, neni 24, germa d, neni 73 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e gjobës për shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje

VËREN SE :

Procedura

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.1208, datë 27.08.2025, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK", vendosi

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët, nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK ,nëpërmjet kontrollit të përbashkët, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, vendosjen e gjobës mbi:
 - a. shoqërinë Balfin B.V., në masën lekë,
 - b. shoqërinë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, në masën lekë,
 - c. shoqërinë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, në masën lekë,

Nga verifikimi i të dhënave financiare të shoqërive Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje. "Deklaratat", dërguar pranë Autoritetit të Konkurrencës me e-mail në datë 21.08.2025, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se xhiroja nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë Balfin B.V është lekë dhe xhiroja nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje është ne vlerën euro ose lekë.

Nga vlerësimi i këtij informacioni, konstatohet se masa e gjobës së vendosur me vendimin nr.1208, datë 27.08.2025 për shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje , ka tejkaluar masën e përqindjes sipas parashikimeve të nenit 73 të ligjit.

Për sa më sipër dhe mbështetur në nenin 112 "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktet administrative" të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioni i Konkurrencës gjykon se është në kushtet që organi publik, në çdo kohë, mund të korrigjojë gabimet në përlllogaritje, të një akti administrativ, dhe mbështetur në nenin 73, pika 1 e ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", përlllogarit dhe korrigjoi masën e gjobës ndaj shoqërive Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, duke e vendosur brenda kufijve të përcaktimit ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, germa a) dhe c) të vendimit nr.1208, datë 27.08.2025, "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK", si më poshtë:

- a. shoqërinë Balfin B.V., në masën lekë,
 - c. shoqërinë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, në masën lekë,
2. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Leida MATJA	Rezana KONOMI	Durim KRAJA	Fatjola DELIJA
			
Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Denar BIBA



Kryetar

